



# Sfidat e emigrantëve të kthyer në integrimin në vend Fokusi tek familjet (me fëmijë)

*Gjetjet për Rajonin e Tiranës*

*Maj 2017*



WITH FUNDING FROM  
AUSTRIAN  
DEVELOPMENT  
COOPERATION



# Sfidat e emigrantëve të kthyer në integrimin në vend Fokusi tek familjet (me fëmijë)

*Gjetjet për Rajonin e Tiranës*

Ky vlerësim i referohet informacionit të mbledhur gjatë periudhës Mars – Prill 2017 nga **Observatori për të Drejtat e Fëmijëve (Observatori)** nëpërmjet intervistave me institucionet qendrore, lokale dhe ofruesit e shërbimeve si dhe nëpërmjet fokus grupeve me emigrantë të kthyer, në qarkun e Dibrës, Fierit dhe Tiranës.

Iniciativa për realizimin e këtij vlerësimi është realizuar në bashkëpunim me **Agjensinë Austriake për Zhvillim (ADA)**.

Përmbajtja e këtij publikimi është përgjegjësi e Observatorit dhe nuk shpreh domosdoshmërisht opinionin e ADA.

©Observatori/ ADA, Maj 2017

## HYRJE

Gjatë 3 viteve të fundit (2014-2016), Shqipëria ka marrë vëmendjen e autoriteve ndërkombëtare si një nga vendet kryesore të origjinës së emigrantëve të paligjshëm drejt vendeve anëtare të Bashkimit Europian (EU) sidomos drejt Gjermanisë<sup>1</sup>. Largime të konsiderueshme të individëve, kryesisht familjeve me fëmijë, ndodhën në rajone të caktuara të vendit<sup>2</sup>. Pa kaluar shume kohë, ky fenomen u shoqëruar me atë të rikthimit të tyre të detyruar në vend. Refuzimi i kërkesave të tyre për azil në vendin e huaj, nënkupton fillësën e procesit të deportimit në vendin e origjinës. Autoritetet shtetërore të të dyja vendeve vendosen në kontakt për të organizuar kthimin e tyre në vend. Në pjesën më të madhe të rastit, pika hyrëse mbetet Aeroporti “Nënë Tereza” i Tiranës. Ministria e Punëve të Brendshme (MPB) [Drejtoria e Përgjithshme për Kufirin dhe Migracionin (DPKM)], dhe në rastin e fëmijëve të pashoqëruar edhe Shërbimet Sociale Shtetërore (SHSSH) mbeten pikat fokale të regjistrimit të të kthyerve<sup>3</sup>.

Përgjithësisht dihet pak mbi këtë kategori të popullatës, duke qënë se pak është investiguar/exploruar mbi profilin e tyre, shtrirjen e fenomenit dhe pasojat që ka kryesisht te fëmijët. Vlerësimi i zhvilluar nga Observatori për të Drejtat e Fëmijëve (më poshtë, Observatori) me mbështetjen e Agjensisë Austriake për Zhvillim (ADA) synon të identifikojë/kuptojë disa nga nevojat e familjeve në procesin e riintegrit të tyre në vend pas kthimit nga emigracioni. Duke u perpjekur për ta mbajtur sa më të fokusuar targetin e vlerësimit, grupi në fokus mbeten familjet (me fëmijë) të deportuar në vend, pa u zgjeruar në nëngrupe të tjera të emigrantëve (p.sh. sezonal, etj). Vlerësimi i mëparshëm nga Observatori<sup>4</sup> vë në dukje problematikat në arritjen e kësaj grup popullate nga institucione të ndryshme lokale, duke nënkuptuar ekzistencën e sfidave të mundshme në riintegrimin e tyre në shërbimet bazë lokale (shëndëtesia, arsim, mbrojtje sociale, punësim, pensione).

<sup>1</sup> EUROSTAT databaza e aksesueshme në:

<http://ec.europa.eu/eurostat/data/database>

<sup>2</sup> UNICEF dhe Observatori. 2015. *Emigrimi masiv i qytetarëve shqiptarë drejt vendeve të BE-së dhe kapaciteti i njësisve të reja administrative dhe njësisve funksionale për të përballuar nevojat e emigrantëve të kthyer*. E disponueshme në: <http://observator.org.al/sq/shqyrtim-rasti-emigrimi-masiv/>

<sup>3</sup> UNICEF dhe Observatori. Nëntor 2016. *Migrantët e kthyer shqiptarë: një vështrim i përgjithshëm i manaxhimit të të dhënave me fokus fëmijës*. E disponueshme në: <http://observator.org.al/ep-content/uploads/2016/12/Vezhgim-rasti-06-12-2016.pdf>

<sup>4</sup> ibid

Për të realizuar një qëllim të tillë, Observatori ndoqi një metodologji hulumtimi cilësore duke përdorur burime të ndryshme të informacionit, si më poshtë:

- Intervista me institucionet qendrore [Ministria e Arsimit dhe Sportit (MAS), Ministria e Punëve të Brendshme (MPB), Ministria e Shëndetit(MSH) dhe Ministria e Mirëqënies Sociale dhe Rinisë (MMSR);
- Intervista me institucionet lokale [Drejtoritë Arsimore Rajonale (DAR) / Zyrat Arsimore (ZA), Drejtoritë Rajonale të Shëndetit Publik (DRSHP), Drejtoritë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror (DRSHSSH), Drejtoritë Rajonale të Shërbimit Kombëtar të Punësimit (DRSHKP), Bashkitë, Sportelet e Migracionit dhe Drejtoritë Rajonale të Policisë së Kufirit dhe Migracionit(DRPKM)];
- Intervista me ofrues të shërbimeve (Shkolla, Qendra Shëndetësore, Zyra të Gjendjes Civile);
- Fokus Grupe me emigrantë (prindër) të kthyer.

Vlerësimi u fokusua në tri zona fillestare: Dibër, Fier dhe Tiranë. Përzgjedhja e rajonit të Tiranës ka ndodhur për shkak se ky rajon është edhe kryeqyteti i Shqipërisë si edhe rajoni më i populluar dhe me popullsinë më heterogjene në vend (Numri total i popullsisë në vitin 2016 llogaritet të jetë 1,148,642 banorë, ku 22.76% përbëhet nga fëmijë të moshës 0-18 vjeç<sup>5</sup>). Në këtë qark gjithashtu ndodhet aeroporti i vetëm ndërkombëtar, i cili është edhe pika kryesore hyrëse për emigrantët e kthyer. Sipas INSTAT<sup>6</sup>, Tirana është edhe rajoni me numrin më të lartë të emigrantëve si dhe destinacioni kryesor për emigrantët e kthyer.

Në vijim, prezantohen gjetjet e përftuara, të renditura sipas fushave të ndryshme të shërbimeve, për të kuptuar më mirë nevojat dhe sfidat e identifikuara.

<sup>5</sup> Të dhënat të disponueshme në: <http://observator.org.al/odf2/qarqet-en.html>

<sup>6</sup> INSTAT, 2013

## GJETJET E VLERËSIMIT



### Shërbimi i pritjes në vend

Për shkak të statusit të tyre (deportim në vendin e origjinës), pika e parë e kontaktit mbetet DPKM, në pikat kufitare. Të kthyerit, pjesë të fokus grupeve të këtij vlerësimi, shprehën pak për këtë kontakt fillestar, duke u shprehur edhe për gjendjen e vështirë emocionale në të cilën janë. Në rastin e rikthimit të fëmijëve të pashoqëruar, institucioni tjetër i rëndësishëm është DRSHSSH, duke kryer intervista dhe vëzhgime në familjen e të miturit me qëllim mbledhjen e informacionit në lidhje me situatën socio-ekonomike të familjes së të miturit si edhe rreth gadishmësisë dhe mundësisë së tyre për ta pritur këtë të mitur.

DRSHSSH Tiranë konfirmon ndjekjen e procedurave nga mbledhja e informacionit për familjen e të miturit deri te informimi i familjes për detajet e mbërritjes së të miturit (ose sistemimin e tyre në qendrat shtetërore të përkujdesit social), si dhe asistimin më tej të rasteve. Nëpërmjet bashkëpunimit me zyrat e punës janë munduar të sigurojnë një mundësi punësimi për familjarët e fëmijëve të kthyer, apo duke bashkëpunuar me Njësitë për Mbrojtjen e Fëmijës (NJMF) të njërive përkatëse në lidhje me rastet kur fëmijët riatdhesohen pasi ka filluar viti shkollor, për të bërë të mundur lehtësimin në procedurat për rregjistrimin e tyre në shkollë dhe ndjekjen e saj.

Vështirësi hasen në kontaktimin e familjes pasi një pjesë e tyre refuzojnë komunikimin dhe dhënien e informacioneve, me shpresën se në këtë mënyrë do të sigurojnë qëndrimin e minorenëve jashtë vendit.

Ka raste që administratori shoqëror i njësisë administrative ku familja e të miturit është banore, nuk ka informacion për të, pasi nuk është përfituese e programeve të mbrojtjes sociale. Kjo sjell vështirësi në të dhëna dhe në verifikim.

Sportelet e Migracionit konsiderohen si porta e parë hyrëse për lehtësimin e procesit të riintegritimit për emigrantët e kthyer, duke i referuar ata në shërbimet e nevojshme. Edhe pse me varësi të departamenteve të ndryshme të MMSR, ato janë të lokalizuara pranë Zyrave të Punës dhe funksioni kryesor i tyre lidhet edhe me funksionin e Zyrave të Punës, pra ndërmjetësimi në

punësim. Nga diskutimet me emigrantët e kthyer rezulton se shumica e e tyre nuk e njohin ekzistencën e këtyre sporteve.



*“Nuk i njohim sportelet e migracioni”*



## Shërbimet e Mbrojtjes Sociale

Faktori kryesor i përmendur nga vetë qytetarët që i ka shtyrë ata të marrin vendimin për të emigruar (ose për të nisur fëmijët e tyre në emigracion) ka qënë gjendja ekonomike e tyre.



*“(Kam emigruar) për arsye ekonomike dhe për shkak të papunësisë”*



Gjasat që situata e tyre të ketë pësuar përmirësim pas kthimit nga emigracioni janë të ulëta, duke marrë në konsideratë që pjesës më të madhe të qytetarëve shqiptarë që kanë qënë emigrantë të parregullt nuk iu është dhënë mundësia të punojnë në vendin e destinacionit.



*“Shita makinën për t’u larguar dhe u ktheva pa asnjë progres”*



DRSHSSH Tiranë pranon se nuk i trajtojnë të kthyerit nga emigracioni si kategori të veçantë. I vetmi shërbim që ofrohet nga ta është pajisja me Ndihmë Ekonomike (NE) në rastet kur familja plotëson kushtet për të qënë përfutuese, duke mos patur kështu asnjë dallim nga pjesa tjetër e popullsisë.

Kjo pohohet edhe nga vetë emigrantët e kthyer të cilët pranojnë se kanë ndjekur procedurat normale për t’u bërë pjesë e skemës së NE. Vlen për t’u theksuar se atyre iu është ndërprerë NE në rastet kur personi përgjegjës për tërheqjen e saj ka qënë në emigrim dhe nuk është paraqitur për një periudhë 3-mujore për tërheqjen e NE. Këtyre individëve, për t’iu rikthyer përfitimit të saj, iu është dashur të ndjekin procedurat nga fillimi, edhe pse situata e tyre ekonomike përgjithësisht nuk ka patur ndryshim ose është përkeqësuar.

Por pavarësisht mungesës së bazës ligjore për të asistuar në mënyrë të veçantë këtë kategori, për të lehtësuar procesin e ri-integrimit të tyre, DRSHSSH Tiranë asistion në bashkëpunim me administratorët shoqërore

pranë njësive administrative, për mundësinë e aplikimit për NE (në rastet kur familjarët nuk janë të informuar për kriteret e përfitimit të saj)

Për sa i përket shërbimeve të tjera të përkujdesit shoqëror, pjesëmarrësit në diskutime shprehin rezervat e tyre në ekzistencën e shërbimeve, p.sh. për fëmijët me aftësi të kufizuar, për nënat me shumë fëmijë, etj. Përkujdesi për këta persona mbetet vetëm në sigurimin e Pagesës për Aftësinë e Kufizuar (PAK), apo në pagesën e pensionit, pagesë e cila ka vazhduar njëlloj si para emigracionit.



*“Marr pension sepse kam trinjakë. Nuk më është ndërprerë gjatë kohës që isha jashtë”*



## Shërbimet e punësimit

DRSHKP Tiranë identifikon dhe mbledh informacion në lidhje me emigrantët e kthyer bazuar në vetëdeklarimin e individëve që i drejtohen Zyrave të Punës. Këto zyra janë përgjegjëse për ndërmjetësimin në gjetjen e një vendi pune për individët të cilët i drejtohen atyre si dhe për ofrimin e kurseve profesionale në rastet kur kjo gjykohet e nevojshme. Në listën e fëktorëve të cilët i japin përparësi aplikimit të një individ, ndër të tjera (të qenit kryefamiljare femër, të qenit nënë me shumë fëmijë, të sapo dalë nga bankat e shkollës, etj), është edhe fakti nëse individ i ka qënë emigrant, por përparësitë reale që i ofrohen kësaj kategorie të popullsisë mbeten me pikëpyetje, edhe pse nevoja e tyre për të siguruar një vend pune është imediate.



*“[Pas kthimit] Kisha nevojë të gjeja një punë dhe të regjistroja fëmijët në shkollë”*



Pjesa më e madhe e migrantëve të kthyer në qarkun e Tiranës të cilët i janë drejtuar këtyre zyrave, nuk shprehen të kënaqur në lidhje me shërbimet e ofruara ndaj tyre. Vonesat apo pamundësia për t'i siguruar atyre një vend pune shihet si një barrierë kryesore në ri-integrimin në vend të kësaj kategorie.



*“Iu drejtova zyrave të punës por niveli i ulët arsimor nuk më lejon të gjëj një punë”*



*“Nuk kam marrë ndonjë shërbim apo lehtësi në zyrat e punës”*





## Arsimimi i Fëmijëve

Në sektorin e arsimit janë marrë masa konkrete nga institucionet qendrore për mbledhjen e të dhënave, arritjen dhe integrimin e fëmijëve të familjeve të kthyer në sistemin arsimor. Një udhëzues specifik është lëshuar nga MAS për ekzekutim nga institucionet në varësi, për të marrë masa mbi regjistrimin prioritar në kopshte dhe shkolla të këtij grupi të popullatës, dhe ndjekjen e rasteve përmes planeve individuale mësimore.

MAS gjithashtu ka hartuar një fletëpalosje informative që përmban informacion rreth procesit që duhet ndjekur për të regjistruar fëmijët në shkollë e cila i është shpërndarë çdo pike kufitare.

DAR Qarku Tiranë, DAR Qytet Tiranë, ZA Kamëz dhe ZA Kavajë gjithashtu pohojnë se i kanë marrë këto udhëzime dhe se kanë dërguar instruksionet e duhura në çdo shkollë për zbatimin e tyre.

Nga intervistat e kthyer me stafin e shkollave dhe nga fokus grupet me emigrantë të kthyer, pranohet se realizohet njesimi i dokumentave në DAR/ZA, por shërbimet e tjera nuk aplikohen në mënyre të standartizuar.



*“Dy fëmijët e mi ndoqën një vit shkollë atje dhe pasi u kthyem u regjistruan në klasën pasardhëse. U bë konvertimi i dokumentave dhe u testuan, por nuk u trajtuan me një plan individual mësimor apo me shërbime psikologjike”*



Aplikimi i planit individual mësimor hidhet poshtë nga pjesa më e madhe e pjesëmarrësve në fokus grupe, ndërsa stafi i shkollave shprehen se realizojnë orë shtesë pas orëve të rregullta mësimore për të ndihmuar nxënësit e kthyer të mbushin boshllëqet e lindura për shkak të shkëputjes nga shkolla për një periudhë kohe. Ajo që bie në sy është mungesa e udhëzimeve konkrete për mënyrën e aplikimit të këtyre planeve individuale.

Nga fokus grupet evidentohet gjithashtu se performimi i një testimi nuk realizohet në të gjitha rastet. Për t'u theksuar vlen edhe mosofrimi në masën e duhur të shërbimit psikologjik për fëmijët e kthyer. Mosaplikimi i një plani individual adekuat dhe mosofrimi i shërbimit psiko-social lidhet kryesisht me burimet njerëzore të pamjaftueshme për realizimin e këtyre proceseve. Këto detyra kryehen kryesisht nga stafi ekzistent në shkolla dhe janë detyra të shtuara të cilat mund të shkojnë përtej kapaciteteve të tyre.





## Shërbimet shëndetësore

MSH ka përgatitur fletëpalosje që përmbajnë informacion për procedurat dhe dokumentat që duhen siguruar nga qytetarët shqiptarë të kthyer nga emigracioni në mënyrë që ata të mund të riintegrohen në skemën e sigurimit shëndetësor dhe të përfitojnë nga shërbimet shëndetësore. Ky informacion është publikuar gjithashtu në faqen zyrtare të MSH. Sipas MSH në DRSHPT-ë, dhe në Autoritetin Shëndetësor Rajonal (ASHR) Tiranë janë ndërtuar shërbimet psiko-sociale dhe shërbimet e shëndetit mendor. Në këto shërbime trajtohen gjithashtu edhe emigrantët e kthyer sipas nevojave që ata paraqesin, por këto shërbime nuk janë përmendur në asnjë nga intervistat në DRSHPT, në Qendrat Shëndetësore apo në fokus grupet me emigrantë të kthyer.

Emigrantëve të kthyer u mundesohet shërbimet shëndetësore si: regjistrimi te mjeku i familjes, pajisja me kartë shëndeti dhe kontrolli i gjithë skemës së vaksinimit, shërbime që shkojnë në të njëjtën linjë me shërbimet e ofruara ndaj pjesës tjetër të popullsisë. Por disa vështirësi mbeten në identifikimin e të sapokthyerve.



*“Nuk e di nëse fëmija im duhet të marrë ndonjë shërbim mjeksor. Njoftohesha gjithmonë nga stafi i qendrës shëndetësore në lidhje me vaksinimin, por nuk kam marrë ndonjë njoftim pasi jam kthyer. Ndoshta nuk e dinë që jemi kthyer”*



Edhe vetë emigrantët e kthyer pohojnë se nuk ju kanë lindur probleme gjatë kohës që ata janë paraqitur për të marrë shërbime shëndetësore.



*“Nuk jemi përballur me ndonjë vështirësi në lidhje me shërbimet shëndetësore. Jemi shërbyer si gjithmonë”*



Ofrimi i këtyre shërbimeve ka vazhduar në të njëjtën mënyrë si përpara emigrimit (falas ose me pagesë në varësi të pagës së sigurimeve shëndetësore nga ana e tyre).

Përsa i përket pajisjes me sigurime shëndetësore, kjo lidhet kryesisht me statusin e punësimit të individit. Në rastet kur individit është i punësuar në mënyrë të rregullt, paguhen edhe sigurimet shëndetësore sipas ligjit në fuqi.

## PËRFUNDIME



*“Nëse do të mundja [të tentoja të ri-emigroja], do ta provoja përsëri. Në Shqipëri na mungojnë shërbimet bazë”*



Një përfundim i rëndësishëm i këtij eksplorimi është se kjo kategori në të vertetë përben një grup popullate me nevoja të veçanta, dhe i shtohet grupeve të cënueshme. Kështu, nga analizimi i situates, si faktorë kryesorë që i kanë shtyrë këta individë të largohen nga vendi dalin në pah ato të lidhura me kushte të vështira ekonomike, mungesë e marrjes së shërbimeve specifike të nevojshme, etj. Shumica e faktorëve në fakt lidhen me kushtet më të favorshme të mirërritjes së fëmijëve. Largimi i tyre ka shtuar vështirësitë e tyre, duke patur parasysh përdorimin e të gjithë burimeve të mundshme. Për të tepër, në kthimin e tyre në atdhe, procesi i riintegrit të tyre është sfidues.

Ky vlerësim konfirmon se pjesa më e madhe e migrantëve të kthyer, të cilët kanë jetuar jashtë për një periudhë të caktuar kohore, kur kthehen në vend, përballen me sfida në aksesin dhe cilësinë e marrjes së shërbimeve të nevojshme. Edhe pse institucionet shtetërore, si qëndrore ashtu edhe lokale, kanë ndërmarrë iniciativa për të lehtësurar procesin e riintegrit të emigrantëve të kthyer, disa situata akoma nuk kanë gjetur zgjidhje plotësisht. Gjithsesi, këto ndërmarrje nuk janë të integruara për të parë familjen në të gjithë spektrin e nevojave. Pjesa më e madhe e shërbimeve të ofruara janë në bazë sektorësh, por pa ofruar mundësinë e shërbimeve të integruara për këtë grup të popullatës.

Nga gjetjet e këtij vlerësimi del se:

- Barriera kryesore me të cilën përmballen qytetarët shqiptarë të kthyer nga emigracioni mbetet mungesa e informacionit përse i përket institucioneve ku ata mund të drejtohen në lidhje me nevojat e tyre. Kështu, lind nevoja e forcimit të funksioneve dhe kapaciteteve të Sporteve të Migracionit, si edhe promovimi i gjerë i rolit të tyre. Për të lehtësurar marrjen e informacionit për përfitimin e shërbimeve specifike, secili sektor të përgatisë një paketë me informacion të përmbledhur të shërbimeve që ofron dhe ky informacion të ndahet në pikat kryesore të kontaktit që emigrantët e kthyer kanë me insitucionet (Shkolla, Qendra shëndetësore, bashki, pikat e kalimit kufitar)
- Përse i përket shërbimit të punësimi, pamundësia për t'i ofruar një vend pune emigrantëve të kthyer të shoqërohet me ofrim të menjëhershëm të pagesës së papunësisë dhe paralelisht me ofrimin e një kursi profesional për ata persona të cilët nuk kanë formimin e duhur profesional.

- Të rinjtë shfaqin nevoja të veçanta në kuadër të të ndjekjes së arsimit apo formimit profesional, dhe kjo duhet të mbahet në vemendje për t'u adresuar përmes programeve të targetuara edhe përtej institucioneve shtetërore.

- Sektori i shëndetësisë aktualisht funksionon si një pikë hyrëse/kontakti me këtë kategori. Njohja e këtij fakti duhet të shoqërohet me ndërgjegjësimin/udhëzimin e personelit shëndetësor në identifikimin e fëmijëve/familjeve të kthyer nga emigracioni dhe informimin e tyre në lidhje me vazhdimin e përfitimeve të shërbimeve shëndetësore.

- Përtej vështirësive të ri-futjes në skemën e ndihmës ekonomike, është e nevojshme të adresohen nevojat e këtij grupi të popullatës edhe përmes shërbimeve plotësuese të përkujdesit shoqëror. Për më tepër, është i nevojshëm angazhimi i punonjësve social dhe psikologëve për të ndjekur në mënyrë të vazhdueshme familjet e kthyer nga emigracioni për të lehtësuar përshtatjen e tyre pas kthimit në vend.

- Sektori i arsimit, pavarësisht hapave konkrete që ka marrë për lehtësimin e procesit të riintegrit të fëmijëve të kthyer, përballet me disa vështirësi, të cilat kanë nevojë për t'u adresuar urgjentisht, si: mungesa e udhëzimeve apo trajnimeve për të aplikuar në mënyrë efikase planet mësimore individuale, mungesa e stafit të shtuar për të bërë të mundur zbatimin e këtyre planeve, shërbimi i pamjaftueshëm psiko-social.

- Bashkëpunimi i shkollës me komunitetin e prindërve, klasën ku nxënësi vazhdon, qeverinë e nxënësve duhet bërë i mundur me synim bashkëpunimin e të gjithëve duke krijuar para së gjithash një klimë pozitive emocionale, të cilën ta përdorin në funksion të riintegrit të kësaj kategorie. Edhe realizimi i orëve shtesë në fundjavë apo gjatë pushimeve me plane të veçanta sipas nevojave të fëmijëve të kthyer, mund të rezultojë më efikase se dhënia e detyrave shtesë në lehtësimin e procesit të ri-integrit të këtyre fëmijëve.

- Njësitë e qeverisjes vendore dallohen si insitucioni kryesor ku emigrantët e rikthyer drejtohen për të kërkuar mbështetje. Iniciativa/programe specifike/të dedikuara mund të ndërmarren për t'iu përgjigjur nevojave të kësaj kategorie të popullsisë; për me tepër edhe roli i koordinimit të mbështetjes mund të jetë i tyre.

Si përfundim, bashkëpunimi i të gjithë aktorëve shtetërorë dhe joshtetërorë do të lehtësonte procesin e riintegrit për të kthyerit nga emigracioni dhe do të siguronte plotësimin e nevojave specifike për shërbime për këtë kategori. Promovimi i praktikave pozitive të cilat promovojnë gjetjen e një rruge bashkëpunimi ndërinstucional për zgjidhjen konkrete të rasteve do të ishte një hap mjaft pozitiv, i cili mund të vazhdohet më tej duke u përkthyer në bazë ligjore.

